




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.488/2022
Datë: 14 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Veli Kryeziu, gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/15/2022/GJTHGJL-AD/GJTHGJL.nr.11/2022 dhe marrëveshjes vullnetare të arritur në mes të panelit dhe subjektit të hetimit, të datës 23 nëntor 2022, pas shqyrtimit të bërë në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe bazuar në nenet 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën e mbajtur më datë 14 dhjetor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet marrëveshja vullnetare për pranimin e fajësisë për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/15/2022/GJTHGJL-AD/GJTHGJL.nr.11/2022, e lidhur në mes të panelit hetimor dhe gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Gjilan Veli Kryeziu.
- II. Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Gjilan Veli Kryeziu është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.5, 2.15, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të njëjtit i shqiptohet sanksioni disiplinor vërejtje publike me shkrim.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.369/2022, të datës 08 shtator 2022, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/15/2022/GJTHGJL-AD/GJTHGJL.nr.11/2022, me datë 25 nëntor 2022, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin për këtë lëndë disiplinore si dhe marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë në mes të panelit hetimor dhe gjyqtarit Veli Kryeziu.

Për ta shqyrtuar raportin hetimor dhe marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë, të arritur në mes të gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Gjilan Veli Kryeziu dhe panelit hetimor, Këshilli më datë 14 dhjetor 2022, ka caktuar dhe mbajtur seancë.

Nga raporti hetimor u vërtetua se kërkesa për fillimin e hetimeve disiplinore është e arsyeshme dhe përbënë shkelje në bazë të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit

5-“gjqytari kryen shkelje disiplinore nese ai ose ajo, paragrafi 1-denohet per vepër veprën penale dhe 2, - shkel ligjin dhe pika 2.15-përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e publikut”.

Sipas vlerësimit të panelit hetimor faktet kanë qenë jo kontestuese për arsyeje se kanë qenë publike, subjekti i hetimit në bisedë telefonike me gazetaren e Kallxo.com kishte deklaruar se:” me pas kërcnu me armë e kisha vra” dhe nuk i ka kontestuar edhe subjekti i hetimit.

Gjatë procedurës tek paneli hetimor subjekti i hetimit dhe paneli hetimor kanë arritur marrëveshje vullnetare me të cilën subjekti i hetimit gjyqtari Veli Kryeziu ka pranuar përgjegjësinë disiplinore me të cilën është ngarkuar sipas nenit 5, paragrafi 1 dhe 2, dhe pika 2.15, të përcaktuara në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe ka pranuar që ti shqiptohet sanksioni disiplinor vërejtje publike me shkrim.

KGJK, vlerësoi se marrëveshja vullnetare për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të subjektit të hetimit gjyqtarit Veli Kryeziu dhe panelit hetimor, së bashku me dakordimin e tyre për llojin e sanksionit disiplinor të përcaktuar në nenin 7 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i përmbush të gjitha kushtet ligjore, është i drejtë dhe në proporcion me shkeljen disiplinore të tij, andaj si të tillë edhe e aprovoj.

Vendimi u mor njëzëri nga ana e anëtarëve të pranishëm të Këshillit Gjyqësor.

Me sa u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.488/2022, datë 14 dhjetor 2022

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Venhar Salihu, Kryetar, Gjykata Themelore në Gjilan;
- Veli Kryeziu, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Gjilan;